



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

Numri i lëndës: 2019:084488
Datë: 03.06.2019
Numri i dokumentit: 00344919

C.nr.1657/18

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, trupi gjykues në përbërje prej gjyqtarit Gëzim Shehu - kryetar dhe gjyqtarëve porot Skender Cena dhe Sejfullah Qesko – anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Taulant Rexhëbeqaj, në çështje juridike kontestimore të paditëses B.K nga rr. “...., të cilën me autorizim e përfaqëson av.R. H nga ..., kundër të paditurit S.B nga rr.“...” pa.nr, të cilin e përfaqëson e autorizuar e tij av.N. M nga ..., për shkak, të besimit të fëmijëve, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor - jo publik , me datën 17.05.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditëses B. K nga, **si e bazuar**, ashtu që e mitura L. B e lindur me datën, në ... dhe i mituri L. B. i lindur me datë, në ..., që të dy nga i ati S.B dhe e ëma B. K, i besohen në ruajtje, kujdes dhe edukim të ëmës - këtu paditëses B. K nga

II. DETYROHET paditësja B.K, që t’ia mundësoj të paditurit S. B, kontaktin me fëmijët e tyre të mitur L. B. dhe L. B, në atë mënyrë që çdo javë ditën e premte pas dite nga ora 17:00, e deri ditën e shtunë pas ditë deri në ora 18:00, fëmijët të qëndrojnë tek i padituri si dhe gjatë pushimeve verore dhe dimërore nga 10 ditë fëmijët të qëndrojnë tek i padituri.

III. DETYROHET i padituri S.B që në emër të kontributit për mbajtje të fëmijëve L. B dhe L. B, nëpërmjet nënës së saj, t’ia paguaj këtu paditëses B.K për fëmijën L. B shumën prej 50 € dhe për fëmijën L.B shumën prej 50 €, e në shumë të përgjithshme prej 100 euro në muaj, e cila pagesë do të bëhet për çdo muaj, e më së voni gjer me datën 5 të secilit muaj rrjedhës, në xhirologarinë e paditëses B.K, në formën me para të gatshme apo në çfarëdo mënyre tjetër të përshtatshme, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, apo deri sa ky vendim të mos ndryshohet të gjitha këto brenda afati 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin III në emër të kontributit për mbajtje të fëmijëve mbi shumën e aprovuar e deri në shumën nga 100 euro për secilin veç e veç apo në shumën e përgjithshme prej 200 euro, **refuzohet si e pabazuar**.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja përmes të autorizuarit të saj av. R.H nga, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për shkak të besimit të fëmijëve, si dhe pagesës së ushqimisë, në të cilën ka theksuar se me të paditurin kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore pa kurorë dhe se nga kjo bashkësi kanë lindur fëmijët e tyre të mitur L.B, e lindur me datën 30.07.2010, në ... dhe L. B. i lindur me datë 25.02.2012, në Për shkak të raporteve jo të mira bashkëshortore paditësja me të paditurin kanë shkëputur bashkësinë martesore dhe tanimë nuk jetojnë në një bashkësi. Që nga ndarja – shkëputja e bashkësisë familjare fëmijët e mitur jeton me të ëmën këtu paditësen e cila i ofron kushte të mira për jetë dhe ka një lidhje të veçantë emocionale me të ëmën, ndërsa është interes i tyre që ajo t'i besohet në ruajtje, kujdes dhe edukim të ëmës e cila kontaktin e të miturës me të atin, këtu të paditurin, nuk do ta pengojë.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i paditëses ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë kërkesëpadiisë si dhe i propozon gjykatës që gjatë procedurës të administrohen provat e propozuara dhe të aprovohet kërkesëpadiia, ndërsa në fjalën e tij të fundit ka deklaruar se “në bazë të provave të administruara pa mëdyshje është vërtetuar se është në interes të së miturës që ajo t'i besohet të ëmës. Sa i përket detyrimit për ushqim – alimentacion gjykatës i propozon që të caktoj shumën sipas vlerësimit të gjykatës. Në fund ka propozuar aprovimin e kërkesëpadiisë i ka kërkuar shpenzimet procedurale por nuk i ka specifikuar.

Në Përgjigje në padi i padituri e kundërshton kërkesëpadiinë e paditëses si të pa bazuar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor e autorizuar e të paditurit av. N. M. nga ka deklaruar se sa i përket padisë dhe kërkesëpadiisë të njëjtën e kundërshtojnë dhe I propozon gjykatës që kërkesëpadiia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar. Në fjalën përfundimtare I propozon gjykatës që konform nenit 144 paragrafi 1 që të vlerësojë rrethanat e ambientit se ku janë duke jetuar fëmijët dhe kujdesin që është duke u bërë ndaj të njëjtëve duke u bazuar në provat e administruara në këtë çështje kontestimore andaj, propozon që fëmijët e mitur të i besohen babait të tyre këtu të paditurit S.B. për arsyeje të kushteve më të mira që I ofrohen në shtëpinë e tij, të cilat janë adekuate për mirërritje dhe edukim, në qoftes gjykata vendos që fëmijët të I besohen paditëses, propozon gjykatës që të obligoj paditësen të ia mundësoj kontaktin personal me fëmijët e mitur dhe atë çdo javë ditën e premte pas dite e deri ditën e shtune pas dite ashtu që fëmijët të qëndrojnë me babain e tyre në shtëpinë e tij për arsyeje të krijimit të afërsisë së raporteve në mes të fëmijëve me babain e tyre gjithashtu kërkon që gjatë ditëve të festive dhe pushimeve vjetore të I mundësohet ky kontakte. Në pjesën e padisë lidhur me mbajtje financiare e kundërshton shumën e kërkuar me arsyetim se i padituri nuk ka krijuar marrëdhënie pune të përhershme dhe nuk ka mundësi financiare të mjaftueshme ngase do të I rrezikohej ekzistenca e tij për jetë, shuma e përbalueshme për të paditurin është 50 euro në muaj për të d fëmijët pasi që paditësja edhe në provat e propozuara ka deklaruar se ka kushte të mjaftueshme financiare për mbajtje dhe rritjen e e fëmijëve, andaj edhe në bazë të lartcekurave I propozon gjykatës që kërkesëpadiinë e paditëses të refuzoj në tërësi. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë për përgjigje në padi shumën prej 104 € për seancat e mbajtura për secilën prej tyre nga 135 € gjithsej të shumën prej 540 € gjithsejtë shumën e përgjithshme prej : 644 €.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ekstrakti qendror i gjendjes civile i lindjes në emër të L.B me nr. serik. E. ..., të datës 18.10.2018, të lëshuar nga Komuna e ...; ekstrakti qendror i gjendjes civile i lindjes në emër të L. B. me nr. serik. E., të datës 18.10.2018, të lëshuar nga Komuna e ... raporti me shkrim i Qendrës për Punë Sociale në ... me nr....., nr....., të datës 21.01.2019; kontrata e punës për të paditurin S. B i datës 01.01.2018; Deklaratën e datës 22.02.2019; Certifikatën Pronësore të datës 12.08.2011.

Gjykata pas vlerësimit dhe pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkespadia e paditëses është e pjesërisht e bazuar.

Në bazë të ekstraktit të lindjes për të miturën L. B me nr. serik, të datës 18.10.2018, të lëshuar nga Komuna e, gjykata e ka provuar faktin e lindjes për të miturin L. B, i lindur në, me datën 25.11.2012.

Në bazë të ekstraktit të lindjes për të miturën Lejla Bojaxhi me nr. serik, të datës 18.10.2018, të lëshuar nga Komuna e ... gjykata e ka provuar faktin e lindjes për të miturën L.B, e lindur në ..., me datën 30.07.2010.

Në bazë të raportit me shkrim të Qendrës për Punë Sociale në, me nr....., nr....., të datës 21.01.2019, gjykata ka konstatuar se raporti përfundon me propozimin që fëmijët e mitur L.dhe L. B. t'i besohet në ruajtje kujdes dhe edukim të ëmës së saj – këtu paditëses B. K., ndërsa që çështja e kontaktit të të paditurit me fëmijët e tij të mitur, të lejohet që i ati t'i shoh siç vendos gjykata po ashtu propozon që gjatë festave por kur edhe kur fëmijët gjatë pushimeve verore dhe dimërore të kalojnë nga 10 ditë tek prindi tjetër.

Në bazë të kontratës së punës për të paditurin S. B. të datës 01.01.2018 , gjykata ka vërtetuar faktin se këtu i padituri S.B. gjendet në marrëdhënie të punës në kohë të caktuar pranë sh.p.k dhe realizon të ardhura personale bruto në vlerë prej 259.65 euro në muaj më gjerësisht sikurse në këtë kontratë.

Në bazë të Deklaratës të datës 22.09.2019, gjykata ka konstatuar faktin vëllau K. K. dhe kunata N. K. e paditëses B. K. kanë vendosur që të ndihmojnë të paditësen në vlerë prej 150-250 € në muaj me qëllim të arrijë të majë veten dhe fëmijët e mitur këtu e paditësja më gjerësisht sikurse në këtë deklaratë.

Në bazë të Certifikatën Pronësore të datës 12.08.2011, gjykata ka vërtetuar se prindi i këtu paditëses është pronar i ngastrës kadastrale ZK më gjerësisht sikurse në Certifikatën e Pronësisë.

Baza Ligjore

Sipas nenit 139 par.2 të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK), është paraparë se “Nëse në rastin e jetës së ndarë, prindërit nuk merren vesh se me cilin prej tyre do të jetojë fëmija, vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente...”. Ndërsa me nenin 144 par.1 të LFK-së është paraparë se “Gjykata ose Organi i Kujdestarisë, i cili e merr vendimin mbi besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme t’i hetojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës”. Po ashtu, me nenin 145 par.1 të LFK-së, decidivisht është cekur se “Nëse fëmija jeton vetëm me njërin prind ose me personin e tretë ose në institucion, prindërit do të merren vesh për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën. Në rast të kontestit, vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente”. Me nenin 298 par.1 (të plotësim ndryshimt të LFK) është e paraparë se “bashkëshorti i cili nuk është I aftë të punojë ose për ndonjë arsye tjetër nuk mund të punësohet dhe nuk ka mjete material të mjaftueshme për ekzistenë ka të drejtë në ushqim nga bashkëshorti tjetër në proporcion me mundësitë e tij”. Përfundimisht me nenin 299 të këtij ligji, në mënyrë decidive është paraparë se “bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqiminë nga bashkëshorti tjetër përderisa ai të kujdeset dhe e mbanë fëmijun e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punojë”.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk është kontestues fakti se palët ndërgjyqëse kanë jetuar për një kohë në bashkësi faktike jashtëmartesore dhe se nga kjo bashkësi kanë lindur fëmijët e tyre të mitur L.dhe L. B. Nuk është kontestues as fakti se për momentin fëmijët e mitur janë nën përkujdesjen faktike të ëmës së saj, këtu paditëses B.K. Gjykata duke u bazuar në raportin e Qendrës për punë sociale gjeti se për shkak të moshës së mitur të fëmijëve dhe lidhja emocionale e fëmijëve me të ëmën dhe ndikimi që ka nëna në zhvillimin e fëmijëve në këtë fazë të jetës për të miturit në këto rrethana gjykata konstaton se qëndrimi i fëmijëve me paditësen do të jetë në favor të zhvillimit më të mirë psiko-fizik të fëmijëve.

Sa i përket pjesës së kërkesëpadisë e cila ka të bëjë me pagesën e ushqimisë në emër të të miturës për të paditurën, gjykata vendos sikurse në dispozitivin III të këtij aktgjykimi. Duke pasur parasysh faktin se i padituri realizon pagë mujore prej 240,00 euro neto si dhe faktin se i njëjti tani jeton me prindërit e tij, ndaj të cilëve gjithashtu ka obligim për ti mbajtur gjykata ka vlerësuar se shuma e ushqimisë në lartësi prej 100 euro për të paditurën e në emër të të miturve L. dhe L. B. është reale dhe e arsyeshme mbi bazën e rrethanave të kësaj çështje. Sipas bindjes së kësaj gjykate, mbajtja financiare e fëmijëve të mitur është detyrim prindëror si në rastet kur prindërit jetojnë bashkërisht me fëmijët, e ashtu edhe në rastet kur fëmijët nuk jetojnë me prindërit për shkaqet e parapara me ligj. Prindërit janë të detyruar që t’iu sigurojnë mbajtje financiare fëmijëve pa marrë parasysh gjendjen e tyre financiare. Gjykata vlerëson se përgjegjësia dhe detyrimi i prindërve, që në raport me fëmijët e tyre të mitur të udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës, buron edhe nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e Kombeve të Bashkuara, e cila ka hyrë në fuqi me 02.09.1990 dhe e cila është drejtpërdrejtë e zbatueshme edhe në Republikën e Kosovës. Mbi bazën e të lartcekurave gjykata vendosi sikurse në dispozitivin nën III të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të lartcekurave dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar pjesërisht dhe se e njëjta duhet

të aprovohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e kjo duke marrë parasysh raportin e qendrës për punë sociale që fëmijët e mitur L. dhe L. B, t'i besohet në ruajtje, kujdes dhe edukim të ëmës së saj, këtu paditëses B.K, mënyrën e kontaktit të tij me të miturit L. dhe L. B. sha si dhe lartësinë e ushqimisë për të njëjtën të cilën duhet ta paguaj këtu i padituri S. B deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, apo deri sa ky vendim të mos ndryshohet.

Gjykata e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë së paditëses që ka të bëjë me ushqiminë në emër të mbajtjes së të miturve L. dhe L. B nga shuma e aprovuar nga 50 euro për secilin veç e veç në shumën e kërkuar prej 100 euro, për secilin veç e veç e deri shumë të përgjithshme prej 200 € për arsye se duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar sikurse më lartë e sidomos vërtetimin mbi të ardhurat mujore të të paditurit i cili nuk ka marrëdhënie pune të përhershme mbi bazën e të cilave provave rezulton se i padituri S.B. objektivisht e ka të pamundur pagesën e kësaj ushqimie mbi këtë shumë.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, ngase pala paditëse si palë gjyqfituse nuk i ka specifikuar shpenzimet siç kërkohet në neni 463.1 të LPK-së, ndërsa pala e paditur si palë që ka humbur procesin gjyqësor nuk i takojnë shpenzimet e procedurës .

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1657/18, datë 17.05.2019

B. profesional,
Taulant Rexhëbeqaj

Kryetari i trupit gjykues,
Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.